



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo -Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura III  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit  
P-91  
Prishtinë, më 16 shkurt 2010, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 16 SHKURT 2010

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Slobodan Petroviq dhe Hetem Arifi, anëtarë të Kryesisë.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu, dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Selman Ymeri dhe Sherif Konjufca;

Nga NDI, Rinor Beka,  
Nga OSBE, Floriana Shala.  
Nga ZCN, Blerta Bejtullahu.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe një pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

### **R e n d i t e**

1. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm,
2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare partive politike, të përfaqësuara në Kuvend,
3. Informata për gjendjen e automjeteve të Kuvendit të Kosovës,
4. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Sadik Idriz për lejimin e udhëtimit jashtë vendit.

\*\*\*

- 1. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi Rekomandimin e cekur më lart, mori këtë:

### **VENDIM**

1. Ngarkohet Administrata e Kuvendit - Divizioni i Prokurimit, për zhvillimin e aktiviteteve administrativo teknike të prokurimit për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2008 dhe 2009.
  2. Vlerësimin e ofertave do ta bëjë Komisioni në përbërje prej 5 /pesë/ deputetëve nga anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.
  3. Rekomandimi i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike i paraqitet Kuvendit të Kosovës, për miratim.
- 
- 2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare partive politike, të përfaqësuara në Kuvend, si dhe grupeve parlamentare**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi Propozimin e cekur më lart, mori këtë:

### **VENDIM**

**për ndarjen e mjeteve për financimin e partive politike të përfaqësuara në Kuvend, si dhe të grupeve parlamentare për vitin 2010**

## I.

Në kuadër të buxhetit të miratuar për Kuvendin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, mjetet financiare nga kategoria – Subvencione dhe transfere, paraqesin mjetet e ndara për financimin e partive politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në shumën prej 1,901,783.00 €.

Nga këto mjete, 95% u ndahen partive politike sipas kriterit të vendeve të fituara në zgjedhje për Kuvendin e Republikës së Kosovës, respektivisht shuma prej 1,806,694€ , sipas shtojcës nr.1.

## II.

Për financimin e grupeve parlamentare ndahen mjetet prej 5% nga mjetet e ndara sipas pikës I.

Këto mjete (95.089€), u ndahen vetëm grupeve parlamentare që përbëhen nga partitë politike, nga buxheti i paraparë për partinë e përfaqësuar në grupin parlamentar. Në rast të përbërjes së një grupi parlamentar nga dy ose më shumë parti, mjetet ndahen në proporcion sipas përfaqësimit të tyre në grupin parlamentar.

Mjetet iu alokohen grupeve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në shumën prej 95.089€, sipas shtojcës nr. 2.

### 3. Informata për gjendjen e automjeteve të Kuvendit të Kosovës

Sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, informoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit për gjendjen teknike, mirëmbajtjen dhe shpenzimet për secilin automjet veç e veç.

Kryesia përgëzoi sekretarin për informatën e përgatitur, si dhe kërkoi që edhe në të ardhmen të informohet për gjendjen e automjeteve të Kuvendit.

### 4. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Sadik Idriz për lejimin e udhëtimit jashtë vendit

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkon e cekur më lart, mori këtë:

## V E N D I M

Kuvendi nuk merr detyrime financiare për udhëtimin e deputetit Sadik Idriz, në Gjermani, ngase kërkesa nuk është në pajtim me Vendimin e Kryesisë së Kuvendit, nr. 03-V-094, datë 4 nëntor 2008.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit,  
**Jakup KRASNIQI**

---

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**